



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 20.09.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Engin Beyoglu, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Sami Hamiti.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Engin Beyoglu, zëvendëskryesues.

Shemsi Veseli shprehu keqardhje për mospraninë e kryesuesit në këtë mbledhje, ndërsa pjesa tjetër është në kompetencë të gjyqësorit.

Ai tha se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, mbledhjen duhet ta udhëheqë këshilltari më i vjetër e jo zëvendëskryesuesi për komunitete, duke shtuar se këtë po e thotë për shkak të mbarëvajtjes së mbledhjes.

Engin Beioglu lexoi shkresën shpjeguese të MAPL-së lidhur me thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit në mungesë të kryesuesit, ku thuhet se në komunat ku ka zëvendëskryesues të Kuvendit të Komunës për komunitete, mbledhjet e KPF-së dhe mbledhjet e Kuvendit thirren dhe kryesohen nga zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për komunitete. Kjo shkresë iu shpërnda të pranishëmve në mbledhje.

Shefqet Sylejmani tha se sqarimi lidhur me këtë u dha, kështu që është mirë që këtë çështje ta përmbyllim dhe me këtë përmbyllet edhe çështja e kryesuesit të Kuvendit, z. Hamiti.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë;

Faqe 1 nga 7

2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013-2015;
3. Propozimplani zhvillimor i arsimit të Komunës së Prishtinës 2013-2017;
4. Informatë lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2012/13;
5. Emërimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për ndërmarrjen publike komunale “Stacioni i Autobusëve;
6. Propozimvendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve që iu ka kaluar afati i tërheqjes nga palët, sipas urdhëresës së gjyqit P. nr. 2482/11, dt. 17.07.2012, lidhur me lirimin e pronës së paluajtshme;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **zëvendëskryesuesi**.

Xhelil Bekteshi paraqiti arsyetimin për këtë propozim.

Tefik Mehmeti tha se kemi të bëjmë me një doracak shumë mirë të paraqitur, duke shtuar se buxheti i paraparë është jo i mjaftueshëm, sidomos në fushën e arsimit, duke marrë parasysh nevojën imediate të nxënësve për hapësira shkollore, sidomos të atyre të shkollave fillore. Ai gjithashtu pyeti lidhur me atë se çka ka ndodhur lidhur me ndërtimin e paraparë për shkollën fillore në lagjen “Arbëria”, duke shtuar se nëse nuk ndërtohet këtë vit ndërtimi i paraparë, në vitin e ardhshëm mjetet e dedikuara i devalvon inflacioni. Ky buxhet është jo i mjaftueshëm dhe se Prishtina ka popullsi më të madhe, andaj paraqitet rreziku që ky buxhet të zvogëlohet ende. Ka qytetarë të cilët pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në Prishtinë, ndërsa janë të regjistruar në ndonjë vend tjetër. Në faqe 7 në vend të 2012 duhet të jetë 2013.

Shemsi Veseli përgëzoi për punën e bërë, duke thënë se korniza është në harmoni me buxhetin e Kosovës, por shtoi se sipas Ligjit për menaxhimin me financat publike është dashtë që për këtë çështje të diskutohet më 1 shtator, pastaj të shqyrtohet dhe të diskutohet përsëri, dhe në Kuvend të dalë më 30 shtator, dhe tani del që për këtë mund të zhvillohet vetëm një debat. Nuk është bërë analizë shumëdimensionale dhe se duhet të planifikohet edhe derdhja e mjeteve nga shitja e 500 trojeve dhe të hyrat nga legalizimi i objekteve etj.

Aziz Pacolli tha se në dy takimet që ka marrë pjesë, janë inkorporuar edhe kërkesat e opozitës, sidomos te infrastruktura. Buxheti në pjesën rurale, prej dy milion, është rritur në tre milion dhe kjo është dashtë të ndodhë. Ka qenë e planifikuar të ndërtohet

rruga që shkon për te xhamia e Marevcit, andaj kërkoj sqarim pse ai projekt është hequr dhe pse janë ulur mjetet e parapara prej tre në dy milion.

Shefqet Sylejmani përgëzoi Drejtorinë për punën voluminoze dhe të kryer shumë mirë, duke shtuar se me këtë nënkuptohet edhe puna e bërë nga Kryetari i Komunës, Çdo herë kur punohet si ekip, sukcesi nuk do të mungojë. Planifikimi është vetëm planifikim, andaj nuk do të thotë që është i realizuar 100 %. për krejt atë çka do të ndodhë brenda kësaj periudhe. Është e vërtetë që buxheti për arsim është i pa mjaftueshëm, si për hapësirë shkollore, po ashtu edhe për paga. I kemi diskutuar edhe mjetet e dedikuara për shëndetësi, por edhe në sferat tjera, si në urbanizëm, rini, sport, kulturë etj., andaj jo pa qëllim po e them sepse realiteti dhe rritja e objektivave po i tejkalojnë edhe planifikimet. Ne, si grup parlamentar, do t'i japim përkrahje këtij buxheti dhe urojmë që punët të shkojnë më së miri.

Tefik Mehmeti pyeti se pse nuk figuron në këtë propozim parku në lagjen "Arbëria", si dhe në pikën 1435 të hiqet pjesa në kllapa.

Milazim Vitia tha se në takimin e mbajtur në "Hajvali" ka pas shumë kërkesa nga banorët e atyshëm, si për ndërtimin e rrugëve, shkollave, fushave sportive etj., andaj ka ardhur koha që t'iu krijojmë kushte edhe atyre banorëve në pjesën rurale, andaj propozoj që fondi për pjesën rurale të rritet në tre milion. Në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, propozoj që çdo fshat ta ketë fushën sportive , ndërsa në Sektorin e bujqësisë duhet të investohet më shumë, pasi që ka shumë kërkesa.

Shemsi Veseli tha se është obligim ligjor dhe do të ishte e nevojshme që të parashihen mjete për raste emergjente në rast zjarri.

Agim Gashi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara .

U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013-2015, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **zëvendëskryesuesi**, ndërsa arsyetimin e këtij propozimi e paraqiti **Halim Halimi**.

Shemsi Veseli përshëndeti punën e ekspertëve të bërë përkitazi me këtë propozim, duke shtuar se kjo duhet të merret si shembull edhe për komunat tjera. Ky është një udhërrëfyes për të ecur përpara.

Shefqet Sylejmani e përkrahu këtë propozim, duke thënë se Drejtoria e Arsimit meriton të përshëndetet për punën që ka bërë. Kësaj mund t'i shtohet vetëm edhe dëshira që kjo të zbatohet. Ai paraqiti disa vërejtje, të cilat nuk kishin të bënin me këtë material, por me rregullativat e shtetit. Kemi mbajtur një tubim ku kemi paraqitur

pikëpamjet tona jo për Komunën aq sa për Nivelin Qendror, pasi që këto probleme kanë të bëjnë për tërë shoqërinë. Sa do të gjej zbatim ky plan është çështje e mjeteve dhe e angazhimit.

Aziz Pacolli shprehu mendimin se është për t'u përgëzuar puna e ekipit të këtij projekti. Çdoherë kur është raportuar për suksesin e nxënësve, gjithnjë kam diskutuar. Rezultatet e arritura të mësimdhënësve janë brengose, andaj mendoj se në këtë drejtim duhet bërë reforma dhe duhet të shikohet se kush e meriton ta mbaj ditarin e kush jo.

Behxhet Musliu diskutoi për aspektin urbanistik të këtij plani.

Halim Halimi paraqiti disa sqarime shtesë.

U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimplani zhvillimor i arsimit të Komunës së Prishtinës 2013-2017 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit i informoi **Halim Halimi**.

Mustafë Krasniqi uroi për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor dhe pyeti se a është e mjaftueshme hapësira e paraparë që t'i pranojë të gjithë ata nxënës që kanë mbetur rrugëve. Është mirë që të mendohet së paku për ndërrimin e emrit të disa shkollave profesionale. Ai pyeti edhe lidhur me sigurimin e shkollave dhe shprehu mendimin se është mirë që të mendohet edhe për bursat e nxënësve.

Halim Halimi u përgjigj në pyetjet e parashtruara dhe paraqiti sqarime shtesë.

Aziz Pacolli pyeti se regjistrimi i nxënësve në vitin 2011-2012, sa dallon nga ai i vitit 2012-2013. Njëherësh ngriti shqetësimin lidhur me shkollën fillore "Emin Duraku", e që është zhvendosur te shkolla fillore "Asim Vokshi", ka ankesa që fëmijët e klasave të para deri në të katërta, po mbesin shumë vonë, andaj kjo çështje duhet rregulluar.

Shemsi Veseli tha se është shqetësuese gjetja e dy kilogramëve të substancave narkotike në autobusin që i dërgonte nxënësit e gjimnazit "Sami Frashëri" për ekskursion në Shqipëri, si dhe kanosja me thika dhe rrahja e nxënësve, andaj duhet të krijohen kushte dhe rrethana që këta nxënës të vijnë në mësimin ashtu si duhet. Duhet bërë një sensibilizim që nxënësit të regjistrohen në shkolla profesionale, si ajo bujqësore etj. Në shkollën "Vëllezërit Fazliu" duhet bërë mbikalim ose nënkalm, sepse ka pasur dy viktima të trafikut brenda një kohe të shkurtër. Është mirë që të ndërmerren masa ndaj punëtorëve, të cilët pranohen në punë dhe kërkojnë ndërrimin e shkollave. Është mirë që të funksionalizohet kuzhina e vjetër për institucionet parashkollore dhe të ndërmerren masa konkrete. Ai njëherësh kërkoi vënien e një semafori në afërsi të shkollës "Hilmi Rakovica".

Shefqet Sylejmani kërkoi që për mbledhjen e Kuvendit, të institucionet parashkollore dhe të shkollave fillore të jepet edhe struktura gjinore dhe vendi se ku gjendet shkolla. Ajo çka u propozua lidhur me shkollën e mesme bujqësore “Abdyl Frashëri”, do ta përkrahim edhe ne, por propozojmë që aty të përfshihet edhe agronomia, veterina etj., në mënyrë që të tejkalohet paradoksi i krijuar lidhur me emra. Te shkolla fillore “Emin Duraku”, sugjeroi që nëse nuk është plotësuar numri i nxënësve, të shkojë klasa si tërësi në shkollën “28 Nëntori”. Ai gjithashtu kërkoi të informohet lidhur me atë se sa kanë mbetur pa u përfshirë në shkollimin e mesëm. Ajo çka ka ndodhur lidhur me drogën në gjimnazin “Sami Frashëri”, duhet të ulemi dhe të diskutojmë në nivel më të gjerë dhe të ndërmarrim hapa të shpejtë.

Hazir Borovci përgëzoi për punën e bërë dhe luti që nëse ndonjë nxënës i shkëlqyer nga shtresat e varfra ka mbetur pa u regjistruar, të ndihmohet. Kërkoi që çështja e bursave të mos mbetet vetëm në fjalë. Sigurimi nëpër shkolla duhet të funksionalizohet dhe të jetë në nivelin e duhur. Propozoi që në vendet ku dheu mund të rrëshqas, të ndërmerret diç si preventivë për shkaqe sigurie.

Milazim Vitia tha se në afërsi të shkollës fillore “Nazim Gafurri” parkohen automjete në trotuar të ngarkuara me dru, të cilat paraqesin pengesë për vajtjen e fëmijëve në shkollë, andaj kërkoi që lidhur me këtë të ndërmerren masa.

Tefik Mehmeti tha se te institucionet parashkollore numri i aplikantëve tregon në çfarë gjendje i kemi objektet parashkollore, duke shtuar se disa familje fare nuk kanë nevojë për shpërndarjen e librave falas, andaj propozoi që ato mjete të orientohen gjetiu, ndërsa me libra të furnizohen vetëm rastet sociale.

Halim Halimi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2012/2013, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Zëvendëskryesuesi, në bazë të bisedimeve të bëra më parë, propozoi që anëtar të këtij komisioni të jenë Muhamet Nura dhe Shefki Gashi.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për ndërmarrjen publike komunale “Stacioni i Autobusëve” dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Arsyetimin për këtë propozim e paraqiti **Agim Gashi**.

Shefqet Sylejmani propozoi që titulli i vendimit të shkurtohet dhe të hiqet pjesa pas fjalës automjeteve.

U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve që iu ka kaluar afati i tërheqjes nga palët, sipas urdhëresës së gjyqit P. nr. 248/11, të dt. 17.07.2012 lidhur me lirimin e pronës së paluajjtshme dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja mbaroi në orën 17:20.

**Procesmbajtëse
Alije Gusia**

**Zv. kryesuesi i Kuvendit për Komunitete
Engin Beioğlu**

